



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT I SHKURTËR

Nga procesverbali i mbledhjes së 15-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 14.06.2023, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Idajet Garip, anëtar
7. Zoran Cirkovic, anëtar
8. Ana Guciç, anëtare
9. Sllavisa Trajkovic

Të tjerë prezent

1. Sabedin Bajrami, Drejtorati për Buxhet.
2. Laureta Aahmeti, drejtorati për buxhet
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Përfaqësues të OSBE-së,
5. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Merita Bytyqi,,**

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 14 të Komitetit për Komunitete
2. Informatë – diskutim rreth kornizës afatmesme buxhetore 2024-2026
3. Të ndryshme

Pastaj kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 14 të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstrakteve nga mbledhja 14-të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht votoi.

II

Informatë –diskutim rreth kornizës afatmesme buxhetore 2024-2026

Lidhur me këtë pikë kryesuesi ia kaloi fjalën Sabdein Bajrami, nga drejtorati për Buxhet dhe Financa, i cili në pika të shkurta i njoftoi, rreth Informatës..

Pastaj Kryesuesi e hapsi diskutimin?

Lulmturije Bytyq-Hasani, tha se kam një pyetje që në buxhet të përfshihet renovimi dhe fasadimi i shtëpisë së komuniteteve në Gadime. Po ashtu edhe në Janjevë të bëhet ndërtimi i një qerdhe pasi që fëmijët e komunitetit ku janë duke qëndruar në qerdhe nuk i plotëson kushtet. Si dhe të realizohet një kërkesë të cilën e ka bërë Zorani për rregullimin e rrugës në Grackë.

Sabedin Bajrami, tha se do t'i përcjellim kërkesat e juaja në instanca më të larta dhe shpresojmë që të realizohen.

Shahadije Bikliqi, tha se ne si komitet i kemi bërë disa kërkesa gjatë vizitës në teren në Janjevë dhe shpresojmë që ato kërkesa të merren parasysh.

Skender Bikliqi, tha se është mirë që në Janjevë të bëhen edhe disa investime pasi që ka nevojë për investime tjera.

Lulzim Qerimi, tha se unë çdo here jam kanë afër kërkesave të qytetarëve, por edhe anëtarët e komitetit për komitete nuk kanë qenë aktiv me dhënë kontribut. Ne çdo kërkesë e kemi marrë dhe ato që do të kemi mundësi do të realizojmë. Te qendra e komunitetit ne kemi marrë pjesë aty por janë vjedhura disa pajisje aty, por donatori VORAE është terjek, tani nuk kemi donator njëherë. Në Jenëve ka disa projekte nga komuna dhe me donator.

Idajet Garip, nuk është që është punuar shumë, ka shumë punë në Janjevë dhe aty duhet me shumë të punohet.

Zoran Cirkovic, tha se unë mendoj që duhet që me shumë të jemi aktiv dhe të shohim se çka është e nevojshme për komunitetin tonë.

Lulzim Qerimi, une do ta përkrahi çdo iniciativë që është në të mirën e komunitetit.

Zoran Cirkovic, tha se e falënderoj ekzekutivin për punën që ka bërë për pastrimin e varrezave që ka qenë kërkesë e jona dhe ky ka qenë bashkëpunim shumë i mirë .

IV

Të ndryshme

Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës tha se gjatë vizitës në shkollën e Gadimes nga anëtarët e komitetit është theksuar se komuniteti ashkali po e braktisin mësimin për shkak të gjendjes ekonomike, mirëpo kjo nuk është e saktë, pasi që tani gjendja e komunitetit tani është shumë e mirë. Dhe nuk është kjo arsyeja që po braktiset mësimi, por gjendja është duke u përmirësuar. Dhe unë kërkoj publikisht që ete ndermirën masa ndaj atyre prindërve që i detyrojnë fëmijët që e braktisin mësimin.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se unë nuk kam thënë që mësimi po braktiset për shkak të kushteve , por sipas stafit të shkollës nuk ka vullnet që fëmijët të vijnë në shkollë. Mirëpo nëse 70% e komunitetit ashkali marrin asistencë sociale kjo tregon që kanë kushte jo të mira ekonomike. Mirëpo këta nxënës duhet të subvencionohen që ata me pas vullnet me vazhduar shkollimin.

Shahadije Bikliqi, tha se a ka bashkëpunim këshilli për parandalimin e mësimin në Gadime me atë të Lipjanit.

Zoran Cirkovic, tha gjatë vizitës në teren në Gadime, nuk është gjatë ekonomike ashtu siç po proklamohet këtu, aty shihet që gjendja është e mirë. Unë kam pyet aty se a ka punëtor të komunitetit e kam marrë përgjigje që po është punëtori teknik ka komuniteti ashkali i cili edhe ke prezent aty me neve. Por arsyetimi i prindërve është se nuk po vijnë për shkak të kushteve jo të mira.

Lulzim Qerimi, tha se unë ju thash me herët dhe prapë po e theksoj se jam i gatshëm për bashkëpunim me secilin për të mirën e qytetarëve tonë.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15³⁰.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Skender Bikliqi